



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

MIRATOI:

Evis Berberi

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

TERMA REFERENCE

PËR OBJEKTIN:

**“Sistemim dhe rivitalizim i skarpatave në Plan i Bardhë”
(me çelësa në dorë)**

Tabla përmbledhëse

1. HYRJE	3
2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSËM	3
3. PËRSHKRIM I GJENDJES EKZISTUESE	4
4. QËLLIMI I PUNËS	10
5. OBJEKTIVAT	11
6. KËRKESAT PËR PROJEKT – ZBATIMIN	11
6.1. Raporti i studimit topografik	11
6.2. Raporti i studimit gjeologjik dhe gjeoteknik	12
6.3. Raporti i studimit hidrologjik dhe hidroteknik	14
6.4. Metodologjia e punimeve të ndërtimit	14
6.5. Raporti i shpronësimeve	14
6.6. Kërkesat për leje dhe liçensa	15
6.7. Raporti teknik i Projekt - Zbatimit	16
6.8. Vizatimet	16
6.9. Raporti përfundimtar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis	17
6.10. Volumet e punimeve dhe preventivi	18
7. KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT	19
8. FAZA, AFATE DHE MIRATIMET	20

Materiali përfundon në faqen 20


1. HYRJE

Autoriteti Rrugor Shqiptar me fondet e buxhetit, mbështetur në shkresën e dërguar nga MIE, me Nr. 4014/16 prot., datë 07.09.2022, (*administrua në ARRSH me Nr. 8738 prot., datë 07.09.2022*) për transferimin e fondeve buxhetore për vitin 2022, kërkon që të financojë ndërtimin e objektit: **“Sistemim dhe rivitalizim i skarpatave në Plan i Bardhë” (me çelësa në dorë).**

2. PËRSHKRIMI I PËRGJITHSHËM

Segmenti rrugor Ura e Vashës – Qafë Bualli (Plani i Bardhë) ndodhet në pjesën verilindor të kryeqytetit të Shqipërisë. Distanca nga Tirana është 30km në vij ajrore. Gjeografikisht segmenti rrugor shtrihet në Rajonin Qëndror Malor të Shqipërisë. Rruga zhvillohet përgjatë dhe në anën veriore të brigjeve të lumit Mat, zonë në të cilën shtrihet edhe fshati Plan i Bardhë.


Nga pikpamja gjeologjike, në zonën në studim dhe rajoni përreth, në sipërfaqe takohen depozitime Mesozoneke dhe Kenozoike. Në këtë zonë janë takuar pjesa më e madhe e zonave tektonike të vendit tonë si: Krastë – Cukali, Kruja, Jonike dhe depozitime Pranë-Adriatikut.



(Harta gjeologjike e zonës në studim)

Për sa i përket aksit rrugor dhe skarpatave në gjërmim të kësaj rruge. Punimet e ndërtimit në këtë aks rrugor janë ndërprerë vite më parë. Aty janë kryer punimet e mbushjes së trases

rrugore, gërmimet për hapjen e zonës së lirë që i duhet të zhvillohet traseja rrugore. Si dhe janë ndërtuar veprat e artit si tombinot për largimin e ujrave të shpatit apo dhe disa mure mbajtëse e pritës që i shërbejnë pjesërisht qëndrueshmërisë së trases së rrugës. Të gjitha punimet e tjera si, paketa e shtresave mbajtëse të trupit të rrugës, sistemi i ndrenazimit etj. nuk janë ndërtuar akoma. Prandaj dhe degradimi i skarpatave në gërmim apo dhe në mbushje i këtij segmenti rrugor, ka përparuar shumë më shpjet se në kushtet e një rruge të përfunduar tërësisht.



(Plan – vendosja e aksi rrugor Ura e Vashës – Qafë Bualli)

3. PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Aksi rrugor Ura e Vashës – Qafë Buall, shtrihet në Rajonin Qendror Malor të Shqipërisë. Ky segment rrugor zhvillohet përgjatë dhe në shpatin verior të luginës së lumit Mat. Në luginën e lumit Mat gjendet edhe fshati Plan i Bardhe, nga i cili ka marrë dhe emrin segmenti rrugor. Punimet për hapjen e zonës së lirë për trasenë e rrugës si, gërmimet dhe mbushjet, kanë përfunduar. Gjithashtu janë nërtuar dhe veprat e artit si tombino për largimin e ujrave të shiut. Por masat mbrojtëse ekzistuese për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e skarpateve në disa zona të këtyre segmenteve rrugor, mungojnë apo edhe janë të pamjaftueshme. Mos kryerja në kohë e punimeve për mbrojtjen e skarpatave dhe formacionet gjeologjike ashtu dhe agentet atmosferik, kanë bërë të dalin në pah shumë problematika që mbartin këto skarpata. Burimi kryesor i problemeve që mund të kostatohen me sy të lirë, për këto skarpata janë:

- Rënje e inerteve dhe masivëve shkëmbor në rrugë
- Rënje e dherave në rrugë
- Rrëshqitje e shpateve
- Rrëshqitja planare e formacioneve shkëmbore
- Rrëshqitja në formë pyke e formacioneve shkëmbore

Të gjitha burimet e mësipërme të rrezikut, si rënjet apo rrëshqitjet, kanë shkaqe të bërëbashkëta që mund të klasifikohen si vijon:



- Shkaqe gjeologjike
 - Materiale të dobëta ose të ndjeshme
 - Materiale të përājuara
 - Materiale të prerë, ndarë apo copëtuara
 - Mospërputhje e orjentuara negativisht
 - Kontrast në përshkueshmëri dhe ngurtësi të materialit


- Shkaqe morfologjike
 - Pjerrësia e ngarkimit të shpatit ose kreshta e sajë
 - Ngrirje – shkrirje për shkak të motit
 - Tkurrje – bymim për shkak të motit

- Shkaqe që lidhen me ndërtimin
 - Gërryerja e shpatit ose thembrës së tij
 - Përzgjedhja e gabuar e sistemit të mbajtjes/mbrojtjes
 - Ndërtimi i gabuar i skarpave
 - Asnjë sistem mbështetës/mbajtës


Më poshtë përshkruhet çdo zonë problematike në veçanti, por Kontraktori (konsulenti) duhet të studiojë të gjithë segmentin rrugorë dhe nuk duhet të mjaftohet me zonat e poshtëpërmendura.

<i>Nga Km 31+000 në Km 31+460</i>	
Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Pjerrësia e skarpave jo e saktë 2. Rënje gurësh nga shpati


Nga Km 31+500 në Km 31+560

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Pjerrësia e skarpatave jo e saktë1. Rënje gurësh nga shpati


Nga Km 31+610 në Km 32+018

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">2. Pjerrësia e skarpatave jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati


Nga Km 32+040 në Km 32+250

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Pjerrësia e skarpatave jo e saktë.2. Niveli i ujërave nëntokësor.3. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për rrëshqitje sipërfaqësorë.


Nga Km 32+040 në Km 32+250

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Pjerrësia e skarpatave jo e saktë.2. Niveli i ujërave nëntokësor.3. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për rrëshqitje sipërfaqësorë


Nga Km 32+490 në Km 33+045

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati


Nga Km 33+140 në Km 33+175

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Niveli i ujërave nëntokësor3. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë


Nga Km 33+300 në Km 34+200

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Niveli i ujërave nëntokësor3. Rënje gurësh masiv nga shpati4. Rrëshqitje masive aktive.5. Në pjesën e sipërme të shpatit ndodhet një masiv shkëmborë që mund të shkëputet.

Nga Km 34+380 në Km 34+720

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë.


Nga Km 34+800 në Km 35+220

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë.


Nga Km 35+240 në Km 35+360


Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë.

Nga Km 37+475 në Km 37+820

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë.

Nga Km 37+830 në Km 38+035

Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none">1. Skarpata jo e saktë2. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë.

<i>Nga Km 39+080 në Km 39+400</i>	
Foto	Problematikat
	<ol style="list-style-type: none"> 1. Skarpate në hyrje të tunelit shumë të larta dhe jo të sakta 2. Rënje gurësh nga shpati dhe shenja për shkëputje sipërfaqësorë.

4. QËLLIMI I PUNËS

Ajo çfarë kërkohet në këto Terma Reference është vlerësimi i saktë dhe i detajuar i situatës aktuale të skarpatave në segmentin rrugor Ura e Vashës – Qafë Bualli duke marrë parasyshë pikat si më poshtë:

- Analiza e qëndrueshmërisë së shpateve në gërmim dhe rreziqet e mundshme.
- Hulimtimi i shpateve nga pikëpamja inxhinierike
- Përzgjedhja e masave teknike për qëndrueshmërinë e shpateve
- Pajtueshmëria e këtyre masave teknike me metodat e zbatimit në terren
- Kërkesat për sigurinë në rrugë, mirëmbajtja dhe riparimet në të ardhmen

Kontraktori (konsulenti) i cili do të marrë përsipër do të gjejë një zgjidhje më të mirë tekniko-ekonomike dhe më efekt sa më të vogël në impaktin ndaj mjedisit.

Kontraktori (konsulenti) duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim të mëparshëm që kanë të bëjnë me këtë objekt si, studimet ekzistuese gjeologjike apo dhe hidrologjike

Kontraktori (konsulenti) duhet të mbështetet dhe të konsultohet me standartin shqiptar të projektimit të rrugëve (RrTPRr 2015) dhe të standarteve të tjera të miratuara nga institucione shqiptare për këto ndërtime dhe kategori rruge.

Kontraktori (konsulenti), nw qoftw se wshtw e nevojshme, sipas fazave të projektit të përcaktuara më poshtë do të analizojë dhe të japë të dhëna të hollësishme për shpronësimet e tokës apo objekteve duke dhënë të qarta kufijtë e shpronësimeve dhe llogaritjet e sipërfaqeve sipas pronarëve duke u mbështetur dhe bashkëpunuar me Agjencinë Shtetërore të Kadastrës dhe Pushtetin Lokal.

Gjithashtu Kontraktori (konsulenti) do të duhet të ketë bashkëpunim me Drejtorite Rajonale të Mjedisit.



5. OBJEKTIVAT

Objektivi kryesor i realizimit të këtyre Termave, është kryerja e të gjitha matjet topografike dhe investigimet gjeologo-hidrologjike e duhura për të mbledhur informacionin e saktë dhe të nevojshme për hartimin e një projekt zbatimi dhe ndërtimin e mbrojtjes së skarpatave duke i sistemuar dhe rivitalizuar ato.

Objektivat e mësipërm do të arrihen duke hartuar një projekt të detajuar që paraqet zgjidhjet teknike që sigurojnë qëndrueshmërinë e skarpatave, ndalojnë rënjen e materialeve inerte në trupin e rrugës, duke rritur sigurinë rrugore të përdoruesve të këtij aksi rrugorë. Hartimi i projektit të plotë zbatimi që ndër të tjera përmban Studimin Topografik, Gjeologjik dhe Gjeoteknik, Hidrologjik, Llogaritja e qendrueshmërisë së skarpatave, Ndikimin në mjedis etj. Zgjidhjet teknike të jenë sa më të sigurta dhe me një kosto sa më ekonomike për veprën. Realizimi i punimeve të kryhet sipas projekt zbatimit të miratuar, do të duhet të përmbushë kërkesat:

- Kushteve Teknike të Projektimit të vitit 2015,
- Vendimit të KM nr.722 datë 19.11.1998, “Për miratimin e rregullores së urbanistikës ndryshuar me: VKM nr.401, datë 22004, VKM nr.545, datë 12.8.2004 dhe VKM nr.574, datë 14.7.2010”
- Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë dhe të akteve nënligjore që rrjedhin prej tij.
- Vendimi Nr.312, datë 5.5.2010 për miratimin e rregullores "Për Sigurinë në Kantier"

6. KËRKESAT PËR PROJEKT-ZBATIMIN

Në këtë fazë Kontraktori (konsulenti) do të hartojë projekt-zbatimin i cili përfshin përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Kontraktori (konsulenti) për hartimin e projekt zbatimit, duhet të kontaktojë paraprakisht me pushtetin vendor dhe banorët e këtyre zonave dhe të marrë parasysh propozimet e pushtetit vendor dhe nevojat e komunitetit të zonës. Projekti përfundimtar, specifikimet teknike, preventivi dhe vizatimet duhet të përfshijnë punime të plota civile, detaje arkitekturore, strukturore dhe mekanike të projektimit dhe vizatime për të gjithë fazat e punimeve në detaje të mjaftueshme që ndërtimi të mund të kryhet pa qenë e nevojshme për modifikime të mëtejshme ose modifikime të vizatimeve. Projekti duhet të përfshijë specifikimet teknike të të gjitha materialeve që do të vendosen në vepër si dhe vlerësimin e koston përfundimtare

6.1 Raporti i studimit topografik

Për këtë qëllim do të kryhet një rievim i detajuar i gjithë zonës së skarpatave në studim, dhe jo vetëm. Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe gjatë fazës së zbatimit të punimeve. Zgjidhja teknike duhet të fiksohet në



harta dixhitale dhe gjithashtu duhet të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, të cilat duhet të kenë koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të zgjidhjeve teknike në terren. Sistemi koordinativ i hartimit të hartave topografike do të jetë sistemi shtetëror i miratuar. Në këtë fazë Kontraktori (konsulenti) do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes së piketave kryesore të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve. Raport i veçantë topografik do të përgatitet për veprat e artit dhe vecanërisht për tunelet, në qoftë se parashikohen në projekt zbatimimi. Të gjitha kuotat e terrenit do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni. Raporti i Studimit Topografik duhet të përmbaj si më poshtë:

- Një raport teknik,
- Tabelen e të gjitha pikave të kontrollit dhe shenjave të përhershëm ku të tregohen koordinatat përfundimtare.
- Diagramet GPS dhe triangulacionit (1: 10,000) dhe diagramet traverse (1: 5000)
- Skica e vendndodhjes për të gjitha pikave të përhershme,
- Llogaritjet dhe rregullimet për GPS, triangulation, traversing dhe nivelim të saktë, Të gjitha shënimet në terren,
- Të gjitha informacionin e nevojshëm në formë dixhitale (CD),
- Kompletimin e hartës topografike të plotë në formë digjitale CD.
- Vendosje e fotografive në letër dhe në CD.

6.2 Raporti i studimit gjeologjik dhe gjeoteknik

Për përgatitjen e raportit përfundimtar, Kontraktori (konsulenti) mund të marrë në shqyrtim raportin ekzistues Gjeoteknik dhe Gjeologjik të paraqitur në projektimin e këtij aksi rrugor. Studimi gjeoteknik do të realizohet sipas kategorisë I dhe II të investigimit gjeoteknik të përcaktuar në Eurocode. Në studimin gjeoteknik do të përfshihet investigimi i terrenit, si dhe investigime të tjera në lidhje me vlerësimin e qëndrueshmërisë së shpateve dhe skarpave. Për përcaktimin e distancave dhe thellësive të investigimeve si orientim do të jenë rekomandimet e dhëna në standard “Eurocode” por dhe në varësi të problematikave në terren mund të jetë e nevojshme që të bëhen ndryshime.

Këto investigime do të planifikohen të përfshijnë identifikimin e një zone më të gjërë të cilat mund të kenë ndikim të rëndësishëm në qëndrueshmërinë e skarpave dhe strukturave të parashikuara në projekt zbatimimi.

Investigimet do të kryhen në pikat që përfaqësojnë ndryshimet të kushteve gjeologjike (dhera, shkëmb), dhe ujërave nëntokësore. Këto do të kryhen gjithashtu në varësi të tipit të zgjidhjes teknike (zona rrëshqitëse, struktura mbajtëse, shpate të pa qëndrueshme). Gjatë investigimit konsulenti duhet të konsultohet me Agjensinë e Zonave të Mbrojtura.

Për realizimin e investigimeve gjeoteknik është e rekomandueshme të përdoren dokumentat si më poshtë:

- Raporti gjeoteknik i investigimeve të kryera gjatë ndërtimit të këtij aksi rrugor;



- Hartat topografike;
- Harta të vjetra të zonës;
- Harta dhe përshkrimet gjeologjike;
- Harta dhe përshkrimet hidrogeologjike;
- Foto ajrore;
- Kushtet klimaterike lokale.

Investigimet dhe testet në terren apo laborator, duhet të planifikohen në mënyrë të tillë që të ndjekin rekomandimet e dhëna në standartin referues. Këto rekomandime japin një orientim për distancat dhe thellësitë minimale që duhet të ketë investigimi (sondë ose gropa studimi), testet e rekomandueshme si dhe programimin për numrin e testeve dhe llojin e tyre. Kontraktori (konsulenti) duke u bazuar në këto rekomandime duhet të pregatisë programin e investigimeve dhe testeve.

Nga kampionet e marrë nga shpimet me sonda apo gropa studimi, do të realizohen dhe testet laboratorike të domosdoshëm për përcaktimin e veçorive fiziko-mekanike të terrenit.

Në kompletimin e testeve të investigimit në terren dhe laborator të dhënat do të kalojnë në raportin final të studimit.

Në raportin e studimit gjeologo-inxhinierik duhet të përfshihet qëllimi dhe fusha e studimit duke dhënë:

- Një përshkrim të vendndodhjes së zonës së bashku me zgjidhjet teknike të propozuara;
- Një informacion për zonën e investigimit dhe zonat përreth;
- Gjeologjinë e zonës;
- Hidrogeologjinë e zonës;
- Monitorimin e ujërave nëntokësor;
- Sjelljen e strukturave fqinje;
- Zonat e pastabilizuara (rrëshqitjet);
- Vështirësitë gjatë gërmimeve;
- Fotografitë ajrore;
- Informacione për sizmicitetin;
- Dokumentacionin për investigimet në terren (sondë, gropa studimi) ku të jepen: vendi, data, metodat, standartet dhe rezultatet;
- Përshkrimet e hollësishme të të gjitha shtresave duke dhënë vetitë e tyre fiziko-mekanike. (të dhënat e shtresave të jepen në formë tabelare dhe grafike);
- Dokumentacioni për kryerjen e testeve (terren dhe laborator) ku të jepen: vendi, data, standartet e përdorura, rezultatet duke i dhënë një konsideratë të veçantë rezultateve anormale;
- Identifikimi i zonave të dobëta (dallimi në parametra gjeoteknik, vendndodhja) si dhe rekomandimet përkatëse;
- Analiza e stabilitetit të shpateve dhe gërmimeve;
- Për çdo strukturë duhet të jepet i ndarë studimi gjeoteknik (llogaritje, standarti, testet, foto etj)



- Në raport duhet të jepen komente dhe rekomandime;
- Në raport duhet të shprehet literatura e përdorur.

6.3 Raporti i studimit hidrologjik dhe hidroteknik

Konsulenti në përgatitjen e këtij raporti, mund të marr në shqyrtim raportin ekzistues Hidrologjik dhe Hidroteknik të paraqitur në projektimin e këtij aksi rrugor, duke e plotësuar atë me informacione shtesë. Studimi hidrologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukuritë e prurjeve përgjatë aksit rrugor si dhe të fokusohet në veçanti në problematikat që sjellin këto prurje, skarpatave të rrugës. Raporti i Studimit hidrologjik duhet të përpilohet duke përllogaritur dhe marrë parasysh dhe matjet shumëvjeçare të reshjeve, për zonës në studim me periodë përsëritje të përshtatshme për vetë kategorinë e aksit rrugor. Raporti i Studimit Hidrologjik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- teksti i raportit, parametrat llogaritjet hidrologjike veprat e artit dhe pellgjet ujëmbledhëse.
- materiali grafik, harta, planimetritë.
- konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

6.4 Metodologjia e punimeve të ndërtimit

Gjatë hartimit të projekt zbatimit, Kontraktori (konsulenti) duhet të përpilojë metodologjinë e ndërtimit, e cila, ndër të tjerave duhet të reflektojë dhe çështje të ndryshme mjedisore. Këtu Kontraktori (konsulenti) do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes së materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre. Në këtë fazë gjithashtu, Kontraktori (konsulenti) do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, duhet të qartësojë fazat e ndërtimit dhe skemat e menaxhimit të trafikut meqënëse punimet mund të kryhen pa ndërprerë trafikun të këtij aksi rrugor. Kontraktori (konsulenti) do të përshkruajë në mënyrë të veçantë mënyrën e realizimit të punimeve në skarpatat e larta dhe masat e marra për sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën e përkohshme.

6.5 Raporti i shpronësimeve

Në qoftë se është e nevojshme, kontraktori (konsulenti) do të përshkruajë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen, sipërfaqet e tyre, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit. Konkretisht kontraktori (konsulenti) duhet të paraqesë:

1. Planimetri shpronësimi (në formatin A3) mbi harta kadastrale e vulosur nga projektuesi, në të cilën të jenë të dhënat e pronës që shpronësohet si më poshtë:
 - 1.1. Emër Atësi Mbiemër
 - 1.2. Numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe shpronësimi



- 1.3. Të jenë të rilevuara objektet dhe të percaktohen me ngjyrë të kuqe objektet që preken nga realizmi i projektit.
2. Planimetri shpronësimi (në formatin A3) mbi fotografimin ajror të vitit 2015, në të cilën të jenë të dhënat e pronës që shpronësohet si më poshtë:
 - 2.1. Emër Atësi Mbiemër
 - 2.2. Numër pasurie, zonë kadastrale, sipërfaqe shpronësimi
 - 2.3. Të jenë të rilevuara objektet dhe të percaktohen me ngjyrë të kuqe objektet që preken nga realizmi i projektit.

Për pikat 1 dhe 2, duhet që të jetë një vijë e mbyllur (poligon i mbyllur), në të cilin të jenë të konturuar dhe më "hatch" të lehtë të gjitha sipërfaqet që shpronësohen.

3. Planimetri shpronësimi (në formatin AutoCAD, sistemi koordinativ UTM) mbi harta kadastrale.
4. Planimetri shpronësimi (në formatin AutoCAD, sistemi koordinativ UTM) mbi fotografimin ajror të vitit 2015.
5. Lista e pasurive që shpronësohen, e cila duhet të përmbajë:
 - 5.1. Emër Atësi Mbiemër
 - 5.2. Numër pasurie
 - 5.3. Zonë kadastrale
 - 5.4. Sipërfaqe totale e pasurisë
 - 5.5. Sipërfaqe shpronësimi
 - 5.6. Lloji i pasurisë
 - 5.7. Tabela përmbledhëse në format elektronik "Excel"
6. Kartela e hartave për të gjitha pasuritë që preken (të jenë brenda afatit 1 muhor)
 - 6.1. Kartelat dhe hartat duhet të kenë vulën lidhëse të institucionit (A.SH.K përkatëse)
 - 6.2. Kartelat duhet të kenë faqen e pasme (Seksioni d dhe e)
 - 6.3. Në rast se një kartelë rezulton e mbyllur, duhet të ketë kartelën vijuese bashkëlidhur

6.6 Kërkesat për leje dhe liçensa

Në këtë raport konsulenti do të paraqes lejet apo kërkesat që kontraktori duhet të marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

Pas përpunimit të projektit dhe gjatë hartimit të projektit përfundimtar të zbatimit, Konsulenti duhet të kryej rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet t'i referohet dhe çështjeve mjedisore. Këtu Konsulenti duhet të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit, cilësinë dhe specifikimet e tyre. Në këtë fazë gjithashtu, Konsulenti do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve, të masave për devijimin e pjesshëm të trafikut, sigurinë rrugore apo problematika të tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës. Konsulenti do të hartojë metodologjinë që do punohet në trafik të pandërprerë. Në raport konsulenti do të



paraqes lejet apo kërkesat që kontraktori duhet të marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

6.7 Raporti Teknik i Projekt – Zbatimit

Raporti teknik i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar arsyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit. Raporti përfundimtar i projektit të zbatimit do të jetë i firmosur dhe do të paraqitet në formë zyrtare në A.Rr.Sh për shqyrtim dhe miratim.

Ky raport duhet të përmbajë llogaritjet statike dhe dinamike për të gjitha skarpatat që do sistemohet apo dhe veprat e artit (në qoftëse ka), si dhe duhet të plotësohen me detaje e nevojshme dhe të domosdoshme për realizimin e tyre në objekt. Të gjitha llogaritjet për qëndrueshmërinë e veprave të artit duhet të bëhen nga eksper të fushës, inxhinier strukturis. Ndësa llogaritjet gjeoteknike dhe hidraulike (për qëndrueshmërinë e bazamenti apo të shpateve) duhet të bëhen nga inxhinier gjeoteknik dhe hidrolog. Do paraqiten në mënyrë të veçantë llogaritjet e kryera për mrojtjen skarpata në gërmim dhe qëndrueshmëria e tyre.

6.8 Vizatimet

Konsulenti duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

Horografia	<i>SH 1:5000; 1:2000</i>
Planimetri e skarpatat	<i>SH 1:500; 1:200</i>
Profilet tërthor	<i>SH 1: 100; 1:50</i>
Profila tërthor tip	<i>SH 1:25; 1:50</i>
Harta e rilevimit topografik	<i>SH 1;1000; 1:500; 1:200</i>
Harta hidrologjike (basenet)	<i>SH 1:1 000</i>
Planimetria e largimit të ujrave dhe mbrojtja nga erozioni.	<i>SH 1:500; 1:200</i>
Harta dhe prerjet gjeologjike	<i>SH 1:1 000; 1:500; 1:200</i>
Harta të ndryshme për VNM	<i>SH 1:1 000</i>
Planvendosja e veprave të artit (tombino, mure mbajtës dhe pritës, ur dhe tunele)	<i>SH 1:200; 1:100; 1:50</i>
Detajet e veprave të artit (tombino, mure mbajtës dhe pritës, ura, viadukte dhe tunele)	<i>SH 1:100; 1:50</i>
Plani i menagjimit të trafikut dhe sigurisë në kantier	

I gjithë dokumentacioni i sipërpërmendur duhet të dorëzohet i printuar, vulosur dhe firmosur nga inxhinier të fushave përkatëse. Gjithashtu, dokumentacioni i dorëzuar në format elektronik, duhet të jetë i firmosur elektronikisht.



6.9 Raporti Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

Objekti “Sistemim dhe rivitalizim i skarpatave në Plan i Bardhë” i nënshtrohet procedurës së vlerësimit paraprak të VNM-së, hartimi i Raportit të VNM-së dhe Relacionit Teknik duhet të bazohet në: Vendimin Nr. 686, datë 29.7.2015 “Për Miratimin e Rregullave, të Përgjegjësisë e të Afateve për Zhvillimin e Proçedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe proçedurës së Transferimit të Vendimit të Deklaratës Mjedisore”, i ndryshuar. Për fazën e projekt zbatimit Kontraktori (konsulenti) duhet të dorëzojë:

1. Raportin paraprak të VNM-së
2. Relacionin Teknik të projektit të propozuar

Në Raportin paraprak të VNM-së, duhet të përfshihen:

- a) përkthimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; (Duhet të identifikohen venddepozitimet për mbetjet e ngurta të autorizuar nga pushteti vendor.)
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Në Relacionin Teknik të projektit të propozuar, duhet të përfshihen:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;



- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
 - d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese /përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
 - dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
 - e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
 - ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
 - f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit;
 - g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
 - gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
 - h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
 - i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
 - j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.
- Për fazën e ndërtimit kontraktori duhet të pajiset me Vendimin për VNM Paraparak, të lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

6.10 Volumet e punimeve dhe preventivi

Kontraktori (konsulenti) do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt zbatimi. Volumet do të llogariten në bazë të vizatimeve të paraqitura në projekt zbatimi. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet mesatare të miratuara me VKM dhe për punimet që nuk gjenden në manuale të shoqërohen me analiza teknike.



7. KËRKESAT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT

Sistemi legjislativ aktual ku duhet të bazohet Kontraktori (konsulenti) por jo të limitohet, për fazën e ndërtimit të objektit : **“Sistemim dhe rivitalizim i skarpatave në Plan i Bardhë” janë si më poshtë :**

- Ligji Nr 10164/2009; “Për ARRRSH “;
- Ligji Nr 8378/1998;”Për Kodin Rrugor të Republikës së Shqipërisë” në të cilin përcaktohen kategoritë e rrugës, institucionet përgjegjëse për kontrollin e rrugëve, maksimumi i lejuar i dimensioneve dhe peshës së lejuar të mjetit, sinjalistika e domosdoshme vertikale -horizontale;
- Ligji Nr 10431 dt 09.06.2011:” Për mbrojtjen e mjedisit”;
- Ligji Nr 10440 dt 07.07.2011;”Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe aktet nënligjore që rrjedhin nga ky ligj;
- Ligji Nr.10119, dt 23.4.2009: ”Për planifikimin e territorit të Republikës së Shqipërisë”; (I përditësuar);
- VKM Nr.1214, dt 03.09.2008 “Për miratimin e Strategjisë Sektoriale të Transportit”;
- V.K.M Nr 153/2000 për aplikimin e Rregullores dhe Implementimin e Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë;
- VKM Nr 354, dt 11.05.2016;” Mbi miratimin e manualit të tarifave për shërbime për planifikim territori, projektim, mbikqyrje dhe kolaudim”;
- VKM Nr 628, dt 15.07.2015: “Mbi miratimin e standarteve të zbatimit dhe të projektimit të rrugëve”
- VKM Nr 629, dt 15.07.2015: “Mbi miratimin e manualeve teknike të çmimeve për punimet e ndërtimit dhe analizave teknike të tyre”
- V.K.M Nr.363, dt 18.7.2002:” Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e ndërtimit të objekteve”;
- V.K.M Nr.312, dt 5.5.2010:” Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”;
- V.K.M Nr.2, dt 8.5.2003:” Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”;
- Udhëzim i M.P.P.T Nr.9, datë 3.07.2012 “Mbi auditimin dhe inspektimin e sigurisë rrugore” dhe “Udhëzuesi i Auditimit të sigurisë rrugore”;
- Konventa e shenjave dhe sinjaleve rrugore Vjenë, 8 Nëntor 1968. Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Konvente me Ligjin nr.9142, datë 16.10.2003, dhe Konventa është e vlefshme nga 6 shkurt 2004;
- Marrëveshja Evropiane për arteriet kryesore të trafikut ndërkombëtar (AGR).Republika e Shqipërisë ka miratuar aderimin në këtë Marrëveshje me Ligjin nr.9511, datë 10.04.2006.
- Etj.

Për fazën e ndërtimit kontraktori duhet të pajiset me lejet si më poshtë:

- Përcaktimi i venddepozitimit të inerteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV).



- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit" i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, date 13.05.2015.

8. FAZAT, AFATET DHE MIRATIMET

➤ Fazat

Fazat e parashikuara dhe afatet orientuese për ndërtimin e objektit janë:

Projekti

- Projekti i zbatimit të ndërtimit të rrugës, **4 muaj** nga data e lidhjes së kontratës.
- Oponenca dhe Miratimi i projektit, **2 muaj**

Organizimi i Kantjerit

- Zbatimi i projektit **12 muaj** nga miratimi i projekt zbatimit
- Monitorimi dhe garancia e difekteve **24 muaj**

Të gjitha fazat do të kontrollohen dhe miratohen nga ARRSH. Kontraktori në fund të çdo faze duhet të paraqesë këto raporte:

- Raportet e projektimit (të detajuar sipas proceseve).
- Raportin teknik të detajuar sipas proceseve, topografik, gjeologjik, gjeoteknik, hidrologjik etj.
- Raport të detajuar të ecurisë së punimeve.
- Raportin e monitorimit gjatë ndërtimit.

➤ Afatet

Kontraktori duhet të përcaktojë me detaje sipas fazave të parashikuara afatet kohore të realizimit të punimeve (Grafiku i punimeve). Afatet e dhëna në tabelën më sipër janë vetëm orientuese. Afatet do të jenë funksion i metodologjisë së ndërtimi dhe organizimit të brendshëm të kontraktorit. Në çdo rast afatet e dhëna nga kontraktori duhet të jenë të arsyetuara dhe të shoqëruara me shpjegimet e përdorimit, ciklit të punës së makinerive, fuqisë punëtore.

